

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. S. nga fsh.G., KK-Deçan, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/8-6 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/II.nr.960/15 të dt.23.05.2016, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **16.08.2016**, në prani të Prokurorit të shtetit Mone Sylja, të dëmtarëve N. M., A. Rr. si dhe të akuzuarit A. S., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. S.**, nga fsh. G. KK-Deçan, i lindur me dt..., ku edhe tani banon, i biri i B. dhe i nënës K. e gjinisë H., ka te kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes se varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar, me ID...

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

- me dt. 24.06.2015, rreth orës 14.00 min., në Gjakovë, derisa i akuzuari po e drejtonte (pa patentë shofer) automjetin e udhëtarëve të markës “Toyota 4x4”, me targa të regjistrimit me numër..., përgjatë rrugës “A. Moisiu” në drejtim të rrugës “A. Çeta”, në kundërshtim me nenin 34,42,61 të LSKRR, nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit apo mos veprimit të tij, por me mendje lehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet ose do të parandalojë shkaktimin e saj dhe pasoja është shkaktuar në atë mënyrë i akuzuari A. duke mos pasur kujdes të shtuar për përgjegjësit e tjerë në komunikacion, kur arrin në udhëkryq me rrjedhë të rrumbullakët me rrugën “A. Çeta”, në mënyrë të pakujdesshme kyçet në rrethe duke ia marr përparësinë e kalimit drejtuesit të motoçikletës të markës “Aprilia”, tipi-50, pa targa të regjistrimit, të cilin e drejtonte A. R., nga Gjakova, i cili në momentin kritik ishte duke lëvizur në rreth ku me ç’rast përplaset për automjetin “A”, në pjesën e përparme të krahut të majtë ku si pasojë e këtij aksidenti të trafikut shkaktohen dëme materiale me lëndime trupore, ku lëndime të lehta trupore merr: drejtuesi i motoçikletës A.(D.) R. nga Gjakova ndërsa lëndime të rënda trupore merr bashkudhëtari në motoçikletën e tij N. M., nga Gjakova, të përshkruara më për afërsisht si në Akt-ekspertimin mjeko-ligjor të Dr. M. H. G., me numër të ref. Gja-1359/15, të dt. 02.10.2015.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/8-6 të KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,49,50,51, 73, neni 378/8-6 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **6(gjashtë) muajve**, i cili dënime nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër shpenzimeve procedurale te paguaj shumën prej **60.88 euro** si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30 ,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.960/15 të dt.23.05.2016, e ka akuzuar të akuzuarin A. S. nga fsh. G. KK Deçan, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/8-6 te KPRK-ës, duke propozuar që i akuzuari te shpallet fajtor te dënohet sipas ligjit dhe te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.07.10.2016, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë, Prokurori Mone Sylja, lexon aktakuzën PP/II.nr.960/15 të dt.23.05.2016, dhe deklaroi se mbetet në tersi pran aktakuzës. Lidhur me pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimin të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe shtojë se kërkon nga gjykata që e merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese po që se gjënë si pranimi i fajësisë, gjendjen e varfër ekonomike si dhe faktin se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin.

I akuzuari A. S. gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion dhe shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer nga pakujdesia, në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm, kam kërkuar falje nga të dëmtuarit edhe me parë dhe kërkoj falje sërish para gjykatës nga të dëmtuarit për demin e shkaktuar dhe me të njëjtit jemi pajtuar sipas traditave dhe zakoneve, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe të me shqiptojë një dënim me të butë nga se është hera e parë që kam ra në ndesh me ligjin.

I dëmtuari N. M. deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale me qene se me të akuzuarin jemi pajtuar dhe se kompensimin e demit do ta realizojë nga kompania e sigurimeve.

I dëmtuari A. R. deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale me qene se me të akuzuarin jemi pajtuar dhe se nuk kërkoj kompensim demit me qene se kompensimin e demit e kam realizuar e nga kompania e sigurimeve.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A. S., me dt. 24.06.2015, rreth orës 14.00 min., në Gjakovë, derisa i akuzuari po e drejtonte (pa patentë shofer) automjetin e udhëtarëve të markës “ Toyota 4x4, me targa të regjistrimit me numër..., përgjatë rrugës “A. Moisiu” në drejtim të rrugës “A.Çeta”, në kundërshtim me nenin 34,42,61 të LSKRR, nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit apo mos veprimit të tij, por me mendje lehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet ose do të parandalohet shkaktimin e saj dhe pasoja është shkaktuar në atë mënyrë i akuzuari A. duke mos pasur kujdes të shtuar për përgjegjësit e tjerë në komunikacion, kur arrin në udhëkryq me rrjedhë të rumbullakët me rrugën “A.Çeta”, në mënyrë të pakujdesshme kyçet në rrethe duke ia marr përparësinë e kalimit drejtuesit të motoçikletës të markës “Aprilia”, tipi-50, pa targa të regjistrimit, të cilin e drejtonte A. (D.) Rr., nga Gjakova, i cili në momentin kritik ishte duke lëvizur në rreth ku me ç’ rast përplasat për automjetin “A”, në pjesën e përparme të krahut të majtë ku si pasojë e këtij aksidenti të trafikut shkaktohen dëme materiale me lëndime trupore, ku lëndime të lehta trupore merr: drejtuesi i

motoçikletës A. (D) Rr. nga Gjakova ndërsa lëndime të rënda trupore merr bashkudhëtari në motoçikletën e tij N. M., nga Gjakova, të përshkruara më përfaqësisht si në Akt-ekspertimin mjeko-ligjor të Dr. M. H. G., me numër të ref.Gja-1359/15, të dt. 02.10.2015.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimit i fajësisë nga i akuzuari është bere në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimit është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimitin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij, sjelljen korrekte në gjykim, deklarami i të dëmtuarve se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkojnë kompensim demi me qene se të njëjtit janë pajtuar sipas traditave dhe zakoneve, gjendja e varfër ekonomike, si dhe faktin se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **6 (gjashtë)** muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.277/16 më datë 07.10.2016.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**G j y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

